



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT
të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës,
mbajtur më 31.5.2012, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Prof.dr.Isa Mustafa, kryetar i Komunës, Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefki Uka, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemsi Veseli, Skënder Reçica Liridon Restelica, Afërdita Veliu, Besa Halimi - Zagragja, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdiu, Kimet Zeqa dhe Sadri Ramabaja.

Munguan: Engin Beyoglu, (me leje) dhe Meliza Haradinaj.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE - së, të mjeteve të informimit dhe përfaqësuesit e Kompanisë projektuese "HIDRO-ING".

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit.

Fillimisht **kryesuesi** i njoftoi të pranishmit për kërkesën e Ministrisë, që në afatin sa më të shkurtër të bëhet rishikimi i buxhetit, duke thënë se është detyrë dhe obligim i yni që të vendoset në bazë të atyre konditave, sepse shumë shpejtë do të kalojë në qeveri rishikimi i buxhetit, pra është deri më 15 qershor.

Shemsi Veseli tha se në dy-tri mbledhje kam kërkuar që të na prezantohet raporti tremujor, që faktikisht është obligim në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike, e që obligohet edhe kryetari që të japë për gjendjen ekonomike dhe financiare për realizimin e projekteve dhe dinamikën e tyre. Kërkoj që të konstatohet në proces se ku qëndron arsyeja e mosprezantimit të këtij raporti. Si konstatim të dytë, potencoi se sa i përket rishikimit të buxhetit, është mirë që, për herët tjera, për shkak të shëndetit të demokracisë dhe respektimit të procedurës, patjetër të mbahet një mbledhje e KPF-së, pavarësisht që ka qenë një afat i shkurtër. Megjithatë e përkrahim që të jetë në pikë të rendit të ditës.

Lidhur me shqyrtimin e kësaj pike, rishikimit të buxhetit, kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

U konstatua se njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit;**
2. **Propozimvendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2012;**
3. **Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues “Zona Ekonomike” në Prishtinë;**
4. **Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e strehimores së arinjve dhe shtazëve të tjera të egra;**
5. **Pyetje dhe përgjigje;**
6. **Të ndryshme.**

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit.

Pika e dytë

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2012.

Tefik Mehmeti, në emër të GP të LDK-së, tha se rishikimi i buxhetit bëhet si në çdo institucion tjetër, në të vërtetë ka qenë koha pak më vonë, por për shkak të ngutjes nga organet më të larta, është ardhur tash që të rishikohet, por nuk besoj se paraqet ndonjë problem, sepse këto bartje kanë mundur të shpenzohen edhe me planifikim e vitit të kaluar. Kjo është pra pjesë e punës, ku shihet që për arsye të ndryshme nuk mund të realizohet një projekt apo një shërbim, kalojnë mjetet në një projekt i cili parashihet që mund të realizohet.

Nga ana tjetër, në mosrealizimin e projekteve të parapara kanë ndikuar edhe faktorët tjerë, si çështja e problemeve të pronës etj.

Edhe për disa pika tjera ndoshta ka pasur nevojë të ketë pak sqarime, megjithatë pajtohem, për arsye se pjesa tekstuale është mirë e definuar dhe në pjesën tabelore përputhen shifrat, në fund barazohen.

Ne si GP pajtohem që këto mjete të barten kështu siç janë të parapara.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, fillimisht ngriti një shqetësim rreth ardhjes së kësaj pike për shqyrtim në rend të ditës, duke shtuar se është dashur që kjo të kalojë në KPF, megjithatë pajtohem dhe dëshirojmë që në fund të vitit këto mjete të mos kalojnë për vitin e ardhshëm, pra të realizohen brenda vitit.

Shemsi Veseli tha se për GP të PDK-së, një veprim i tillë nënkupton edhe gjëra tjera, mungon arsyetimi për ndryshimin, pra tamam qysh duhet bërë destinimi i mjeteve, në disa vende nuk janë dhënë kodet dhe nënkodet ekonomike, mos planifikimi real i nevojave, prioriteteve, pastaj shëndetësia, nuk dihen ku do të orientohen mallrat dhe shërbimet, absolut nuk është e definuar.

Duhet të jetë një specifikim më real në nënkategori ekonomike, nuk ka sqarim, pra mbetet e paqartë.

Në anën tjetër, mungon përcaktimi i prioriteteve, që është një tregues i qartë në aspektin e planifikimit që nuk bëhet si duhet, nuk po bëhet identifikimi i drejtë i problemeve me kohë etj. Por, nuk përputhet as shuma e mjeteve nga arsyetimi që është dhënë rreth planifikimit të tyre.

Çështja tjetër që unë desha ta potencojë, nga vet fakti se në pikën 6, programi investimet kapitale, po barten mjete, orientohen në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe tani po vijmë në një situatë që duhet bërë një transfer të tillë, për arsye se nuk e kemi bërë planifikimin ashtu si duhet.

Një nga indikatorët për planifikim, është në këtë rast kuadri profesional dhe stafi menaxhues për monitorim të sistemit të planifikimit, që patjetër duhet të jetë, për arsye që me kohë t'i japë edhe vështirësitë se cilat janë në planifikim, andaj dhe mund të vijmë në situatë që nganjëherë të krijohet përshtypja e keqmenaxhimit të buxheti. Transferi i mjeteve tregon se drejtoritë janë tejet të dobëta në planifikim.

E përkrahim këtë rishikim të buxhetit, por këto janë ato të metat që duhet t'i kemi parasysh, pra qeveria, drejtoritë gjegjëse dhe do të ishte mirë që shuma e mjeteve prej 400 mijë euro të përmirësohet, ose të dalë shuma prej 3 milion e 400 mijë euro.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, përkrahu shumicën e vërejtjeve që u dhanë nga GP i LDK-së dhe GP i PDK-së, përpos pjesës matematikore, që shihet se janë dy tabela, gjegjësisht dy parë të dhëna, dhe qëndrimi i ynë është që në materialin përfundimtar që do të jetë të shpjegimet, të jenë plotësimet që u dhanë këtu. Konsideroj se kjo duhet të jetë si kërkesë për opinionin e përgjithshëm këtu, por edhe për ne këshilltarët.

GP i AAK e përkrah këtë propozimvendim për miratim.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se do të ishte mirë, që edhe parafolësit e thanë, që kur projektohen gjërat të parashihen pak më saktë, sidomos bashkëpunimi me institucionet qendrore të jetë më serioz, se shpeshherë ka ndodhur dhe po ndodhë në vazhdimësi, që projektet e mëdha për Prishtinën po dështojnë dhe ato mjete po barten, dhe sigurisht do të vazhdojnë të barten, nëse vazhdon kjo qeverisje, qoftë e nivelit qendror. E përkrahi këtë bartje edhe i bashkëngjitem mendimit që të harxhohen këto mjete, mos të mbesin suficit. Të kryhen projektet, nuk po o quaj shantazhe, por mos të ketë mospërkrahje prej institucioneve qendrore se, fundi i fundit, të gjitha institucionet janë këto që ju shërben kjo infrastrukturë dhe këto investime.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, fillimisht tha se e përkrahim miratimin e këtij propozimvendimi, me një sugjerim që, te Drejtoria e Arsimit është mirë që inventari dhe bibliotekat për libra të ndahen, sepse, me sa shihet, bibliotekat nuk i kemi të furnizuara sa duhet. A mund të jetë faji pse e kanë të përbashkët me inventar dhe na shkojnë mjetet për pajisje me inventar, që ndoshta ndonjëherë nuk janë aq të domosdoshme, kurse libri, biblioteka është më e domosdoshme të pasurohet në nivel më të lartë dhe më të mjaftueshëm për nxënësit.

Sadri Ramabaja (L V) fillimisht shtoi se miratimi dhe rishikimi i buxhetit është shpërfaqja më e mirë e qeverisjes së keqe të kësaj qeverisje komunale, në fakt është mungesë e bashkëpunimit dhe garës në dëm të qytetarëve dhe qytetarisë, lojë e pingpongut, bartje e përgjegjësisë nga niveli qendror tek ai lokal.

Arsyetimet për bartjen e mjeteve nga një projekt në tjetrin, edhe ky lloj arsyetimi është produkt i mungesës së politikave afatgjata, shprehje e paaftësisë profesionale dhe menaxheriale, por edhe shprehje e hapur e manipulimit politik për efekte elektorale.

Bartja e këtyre mjeteve është ekskluzivisht shprehje e manipulimit flagrant me mjete të taksapaguesve të Kosovës, në kuadër të këtij rishikimi të buxhetit, në përputhje me pikën 2 të këtij vendimi.

Kur është bërë miratimi i këtij buxheti, është premtuar se do të realizohen disa projekte tepër të rëndësishme për lagje të tëra të Prishtinës, si për Matin I dhe Matin II, konkretisht për rregullimin e rrjetit të kanalizimit dhe, shikuar realisht, këto mjete janë bartur në projekte të rendit të dytë, të tretë etj.

Rreth rishikimit të këtij buxheti nuk janë dhënë shpjegime shumë të qarta, sepse barten këto mjete ku janë paraparë për ndërtimin e shkollave etj. etj. në shërbime dhe mallra, respektivisht për shërbime publike apo çka është dhënë shpjegim terciar i parëndësishëm.

Kjo është arsyeja pse nuk mund ta votoj këtë ropozimvendim.

Kimete Zeqa tha se përderisa në këtë program të buxhetit janë paraparë mjete për disa drejtori të tjera, pse nuk ka mundur që për Drejtorinë e Arsimit të parashihen 260 mijë euro, kur këtu thuhet se barten në programin e arsimit, projekte, pajisje, kabinete, inventar shkollor, për libra etj. kurse 450 mijë euro në arsim, gjithsej 710 mijë euro për arsim.

Mendoj se buxheti për shëndetësi është shumë i vogël, nuk di a duhet rishikuar apo konstatuar arsyen pse gjithmonë ndahet buxhet kaq i vogël për shëndetësi. Do të kërkoja të shikohet mundësia e rritjes së buxhetin për shëndetësi.

Lidhur me disa nga vërejtjet dhe sugjerimet e parafolësve, kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

Me shumicë absolute votash, një kundër (Sadri Ramabaja), u miratua rishikimi i buxhetit për vitin 2012.

Pika e tretë

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Planit rregullues “Zona Ekonomike” në Prishtinë, Valentin Jonçaj, përfaqësua nga kompania “HIDRO-ING”, prezantoi, në mënyrë elektronike, planin rregullues për këtë zonë.

Për këtë propozimvendim, kryesuesi hapi diskutimin.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar vendimin për miratimin e Planit rregullues "Zona Ekonomike". Nga ky Kuvend në vitin 2008 është marrë vendimi për fillimin e hartimit të këtij plani rregullues.

Hartimi i këtij plani i është besuar kompanisë "HIDRO-ING".

Është fjala për këtë variantin e dytë që është diskutuar në KPF, që pjesa e majtë e rrugës Prishtinë - Mitrovicë ta ketë edhe një kycje në rrugën kryesore. Po ashtu kërkojmë nga drejtoria që të shikohet harmonizimi i indeksit të ndërtimit të kësaj lagjeje, e cila kufizohet me pjesën e Arbërisë së re, që do të thotë të bëhet një harmonizim i koeficientit të ndërtimit.

Si GP këtë propozimvendim e përkrahim dhe do ta votojmë për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se e përshëndesim përfaqësuesin e kompanisë dhe ekipin e saj, të cilët në mënyrë profesionale prezantuan projektin. Mendoj se është një prej projekteve që mund të zbatohet më së miri në Komunën e Prishtinës, pra është një sipërfaqe e zbrazët, ku të gjitha objektet mund të vendosen ashtu siç parashihen me projekt.

Besa Halimi - Zagragja, në emër të GP të PDK-së, e përgëzoi prezantuesin për sqarimet e detajuara të këtij plani. Përkundë të dhënave që na u prezantuan, do dëshiroja që të dëgjoja nga ky prezantim se cilat janë ato pika që do të zgjonin pak kureshtjen e këshilltarëve, cilat janë rreziqet që priten në këtë, çfarë zhvillime parashihen e kështu me radhë.

Përndryshe, urojmë të bëhet ashtu siç e keni planifikuar.

Mejreme Berisha, në emër të GP të AAK-së, tha se urojmë që ky projekt të realizohet sa më parë.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, shprehu dëshirën që ky projekt të jetë i realizueshëm dhe t'i plotësojë kërkesat e pronarëve dhe uroj që të jetë i realizueshëm dhe në interes të pronarëve që janë atje, se po shihet që në shumë plane jemi provuar, se realizimi është tepër i vogël, sepse po i bëjmë gjërat në tavolinë, pa dalë në terren, pa e shikua gjendjen faktike etj. Prishtina duhet të bëhet një qytet modern. Unë kërkoj prej arkitektëve këtu që në planet detale urbane të parashihet ajo çka është më moderne, maksimalisht të shfrytëzohet hapësira, maksimalisht të plotësohen dëshirat e njerëzve që kanë interesa aty.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se e përkrahim në parim që të zhvillohet ndërtimi i kësaj lagjeje si zonë industriale, por në të ardhmen kjo lagje do të ketë shumë banorë të ri. Konsultimi me banorët që është bërë, mendoj mos të përpiqemi t'iu plotësojmë dëshirat të gjithë atyre që jetojnë sot, por të mendojmë pak ndoshta pas 20-30 vitesh ajo lagje a do të ua plotësojnë nevojat atyre që do të shtohen aty me ndonjë çerdhe apo shkollë. Mendimi ynë është edhe si parti, si subjekt politik, por edhe kështu të jetë i paraparë edhe një objekt fetar. Besoj se këto do të merren parasysh.

Sadri Ramabaja u shpreh se jemi dëshmitar të një degradimi urban në pjesët tjera, ndërkaq, natyrisht, hartuesit nuk janë përgjegjës për këtë degradim të kryeqendrës sonë. Kisha pasur dëshirë shumë që epoka e "kutive të shkrepave" të kishte përfunduar në vitet e 90-ta. Për fat të keq, ajo po ringjallet shumë atje me makutrinë e

ndërtuesve që i kemi edhe këtu, dhe me papërgjegjësinë qytetare edhe të këtij Kuvendi këtu. Natyrisht, për këtë nuk është përgjegjëse firma. Unë e përgëzoj për këtë punën profesionale që ka bërë etj., por ne jemi dëshmitarë se lagjet që kanë kaluar nëpër këtë proces të miratimit të projekteve, janë degraduar në shkallën më të keqe të mundshme, siç janë lagjet: “Tophane”, “Velania”, Lagja e Muhaxhirëve etj.

Shemsi Veseli ngriti shqetësim, duke shtuar se po e shpreh një brengë, e cila është duke vazhduar, d.m.th. Komiteti për Planifikim nuk na jap sqarime të nevojshme se cilat kanë qenë vërejtjet, cilat kanë qenë ato që janë pajtuar, cilat janë sugjerimet, cilat janë propozimet e mundshme etj. Nga tubimet që janë mbajtur me qytetarë, do të duhej të ishte një procesverbal prej 2-3 faqesh. Pra, e njëjta çështje ka ndodhur edhe me planin rregullues për Lagjen e Muhaxhirëve.

Çështja tjetër që dua ta paraqes, për qëllimin më të mirë që ne ta dimë gjendjen faktike, është mirë që të merret vendim nga ekzekutivi, gjithmonë kur të bëhet drafti final dhe kur të bëhet raporti, le të na sjellin edhe neve një kopje që të dihet se si duket ai draft.

Meqë nuk e kemi një plan zhvillimor urban dhe komunal, normalisht që jemi të hendikepuar, mandej edhe këto planet rregulluese kur po bëhen, faktikisht po janë të hendikepuara të gjitha palët.

Megjithatë, për hir që ka të bëjë me interesin e Komunës së Prishtinës, me interesin e qytetarëve të Prishtinës, ne grupet parlamentare në këtë aspekt gjithmonë kemi shprehur politikë frytdhënëse dhe konstruktive.

Si grup parlamentar e përkrahim miratimin e këtij plani rregullues.

Njëzëri u miratua Vendimi për miratimin e Planit rregullues “Zona konomike” në Prishtinë.

Pika e katërt

Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e strehimores së arinjve dhe shtazëve të tjera të egra, të pranishmit i njoftoi Agim Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, i cili tha se për këtë rezervat për kafshë të egra ka shprehur interesimin një fondacion gjerman, i cili do të bëjë investime pas zhvillimit të procedurave përkatëse, sigurimit të lokacionit dhe procedurave të tjera. Kjo është bërë në harmoni me ministritë përkatëse, siç është Ministria e Ambientit dhe Ministria e Bujqësisë.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimvendim dhe do ta përkrahim për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se këtë kemi mundur ta quajmë kopsht zoologjik, megjithatë e përkrahim edhe si strehimore.

Shemsi Veseli tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim si projekt i një donacioni, dhe uroj që t’i përmbahen, por në çoftë se nuk i përmbahen, atëherë me siguri që do të ketë probleme, se duhet pas parasysh grumbullimin e arinjve, sidomos që ata mund të kenë edhe dëmet e veta që mund t’iu shkaktojnë banorëve përreth. Kërkojmë që të plotësohen të gjitha ato që janë zotuar për këtë projekt.

Mejreme Berisha përkrahu këtë si një ide të shkëlqyeshme, se jemi shumë të varfër në këtë aspekt dhe shpresoj se që vërtet Komuna ta marrë këtë çështje seriozisht.

Shefki Gashi tha se do të ishte mirë që të definohet saktë se ku gjendet ky lokacion, ku është caktuar, cila pjesë e komunës së Prishtinës është paraparë për këtë.

Kryesuesi tha se kjo është e rregulluar në bashkëpunim me Ministrin e Planifikimit Hapësinor, pra ekziston pëlqimi nga niveli qendror dhe nga ne.

Feti Mehdiu përkrahu këtë si një ide shumë të mirë dhe uroi që të realizohet. Sa i përket formulimit, do të duhej të formulohej pak më mirë.

Në parim e përkrahim, shpresojmë që të realizohet.

Sadri Ramabaja tha se kemi të bëjmë me një rezervat, e jo me një kopsht zoologjik ose diçka të ngjashme.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, sqarime shitesë dha Agim Gashi.

Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e strehimores së arinjve dhe shtazëve të tjera të egra.

Pika e pestë dhe e gjashtë

Pyetje dhe përgjigje dhe të ndryshme

Aziz Pacolli paraqiti një petition të disa qytetarëve të “Zonës Ekonomike” dhe “Arbërisë”, të cilët janë me numër të parcelave dhe me nënshkrime të regjistruara, duke shtuar se ky peticioni iu ka drejtuar Kryetarit të Komunës dhe drejtorit të Urbanizmit dhe shefave të grupeve parlamentare, por në mungesë të një lokali – zyre në objektin e Komunës, nuk kemi pasur adresë ku me e dorëzuar.

Është një petition i qytetarëve, ku edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa e kemi diskutuar kur kemi pas edhe takimin me kryetarin shifat e Grupeve parlamentare, rreth koeficientit që të barazohet edhe pjesa e Arbërisë III me “Zonën Ekonomike”, andaj është kërkesë e qytetarëve që koeficienti të ngrihet nga 1.2 në 3.6, por konsideroj se ky propozim është pak i lartë. Pëlqimi i përbashkët është që koeficienti të jetë deri diku 2 apo 2.4, kështu që e mora si obligim për me prezantuar këtu në asamble komunale.

Tefik Mehmeti tha se sa i përket përgjigjeve që janë dhënë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, nuk jam i kënaqur, andaj konsideroj se edhe drejtori kishte qenë mirë pak me e shikuar se si është duke u punuar, dhe besoj që komuna ka kapacitet, ka njerëz, ka mundësi për t'i rregulluar ato gjëra, e jo me e lënë ashtu si është shkruar këtu.

Edhe Drejtoria e Infrastrukturës Lokale pjesërisht ka dhënë përgjigje, për arsye se e jap një afat kur ka me kryer ajo rrugë, por pjesën e pyetjes sime kah fundi, që është një problem atje që e kanë paraqitur banorët për një kycje në një përroskë të fshatit, që nuk e kanë paraparë, dhe për këtë është cekur se duhet punë shtesë. Puna shtesë për këtë pjesë të këtij problemi, që konkretisht duhen vetëm pesë tubacione për mbulimin e asaj përroske, kjo vetëm se do ta përfundonte në tërësi këtë projekt. Do të ishte mirë që të kryhet ai projekt, në urën e fundit të asaj rruge Viti – Bullaj, që kycja e saj të bëhet mirë.

Shaip Hajrizi paraqiti disa kërkesa të qytetarëve të lagjes “Kodra e Trimave”, kërkesa të shtruara që më parë, rreth ndërtimeve të objekteve. Shumë qytetarë janë në pritje të një plani urbanistik, por disa nga ata janë tejet të mllefosur dhe kërkojnë një përgjigje më të saktë se deri ku ka shkuar kjo çështje dhe kur pritet të kryhet plani urbanistik për lagjen “Kodra e Trimave I” dhe “Kodra e Trimave II”.

Mejreme Berisha tha se me që është fundi i vitit shkollor për maturantë, e dimë sot ka përfunduar gjithçka edhe na intereson prej Drejtorisë së Arsimit një raport, por është edhe një shqetësim shumë i madh që po na shqetëson neve. Deri sot ndoshta nuk e kam diskutuar këtu në mënyrë publike, por mbajtja e kurseve në lëndë të ndryshme nga profesorë të lëndëve me nxënës të klasave të veta, nuk e di se deri ku do të shkojë më kështu! A kemi organe kompetente për këto çështje apo jo?! Është edhe një problem shumë shqetësues, edhe pse i kemi shkollat e reja, më besoni, jo vetëm në shkollën tonë, por çka është në pyetje kjo higjiena, jo nuk është prej pastruesve, ju lutem, por mungesë të mjeteve apo nuk e di çka.

Edhe një shqetësim linja e “Profitit” prej Matit, më duket se nuk e ka të paraparë me shkuar te shkolla Normale, por e ka Mat - Rreth - Dardani - Tregu i gjelbër.

Janë shumë kërkesa të banorëve të fshatrave të gollakut për rregullimin e rrugëve dytësore, konkretisht në lagjen “Ahmetaj” të Koliqit. Kjo lagje, përmes Bashkësisë lokale, ka bërë kërkesë në Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale që të gjendet mundësia për rregullimin e saj, pasi që prej se është bërë ajo rrugë e re në Koliq, deri te kthesa atje për shkollë, gati 5-6 shtëpi të reja kanë nisur një rrugë dytësore për ta ndërtuar.

Vjollca Dibra - Ibrahim, u shpreh se ka një kohë të gjatë që qytetarët, sidomos të pjesës së Lagjes së Spitalit, por edhe në lagjen “Dardania” edhe në lagjen “Ulpiana”, shihet se kemi problem me qentë endacakë. Për fëmijët që shkojnë herët në ndërrimin e parë në shkollë, tash ndoshta është koha e verës edhe është pak më lehtë, por me fillimin e dimrit do të kemi problem. Për eliminimin e kësaj dukurie duhet të gjendet një zgjidhje, të grumbullohen ata qentë dhe të mos shëtisin nëpër qytet, sepse paraqesin rrezik për qytetarë, sidomos për nxënës.

Shefqet Sylejmani kishte një sugjerim lidhur me disa ankesat dhe vërejtje të disa qytetarëve, të cilëve iu lidhen afatet me punë, duke cekur se janë disa punë që kryhen vetëm verës, dhe nëse e zen vjeshta, nuk punohet më.

Jam për një kërkesë për efikasitetin e nevojshëm që duhet ta ken të gjitha organet tona, e në rend të par Arkivi i Komunës së Prishtinës, sepse po vonohen ndonjëherë kërkesat, shkresat me iu bartë drejtorive të caktuara edhe po mbesin punët në gjysmë.

Kjo është kërkesë dhe mendoj se duhet të ketë konsideratë ndaj kësaj kërkesë.

Shaip Hajrizi lidhur me eliminimin e qenve endacakë, tha se janë disa njerëz që janë duke biseduar me disa kompani të jashtme, që pikërisht janë duke bërë një projekt sikur kjo që ishte pak më parë, që ishte për strehimoren për arinj dhe kafshë të tjera, po ashtu edhe për qentë endacakë, që Komunës nuk i kushton absolutisht asgjë. E gjithë pagesa që bëhet, apo harxhimet që bëhen për atë punë i kryejnë kompanitë e jashtme, vetëm Komuna a është e gatshme që, në rast nevojë, me u ulur me ata njerëz me biseduar dhe me e parë se sa është në interes të Komunës ai projekt.

Naime Osmani, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Desha vetëm një arsye të ma jepni, përse nuk më kthehen përgjigjet.

Po të njëjtën pyetje e kamë edhe për drejtorin e Infrastrukturës Lokale dhe drejtorin e Pronës, të më japin një sqarim të vogël, ndoshta unë kam keqkuptuar apo lidhur me rrugët apo rrjetet e kanalizimeve të cilat kalojnë nëpër pronat private. Si duhet të veprojnë qytetari, të vjen te Drejtoria për Pronë të nënshkruaj, d.m.th. që e lejon të kalojë rrejtë i kanalizimit apo rruga, apo të shkoj në Gjykatën Komunale, gjë që në Gjykatën Komunale unë e kam konsideruar maltretim për qytetarët.

Agim Gashi tha se për eliminimin e qenve endacakë, një kompani që e ka fituar tenderin për sterilizimin dhe kastrimin e qenve, ata i trajtojnë dhe janë duke i trajtuar dhe i lëshojnë përsëri. Nuk kanë mandat që ata t'i mbajnë në afat të gjatë aty. Maksimumi që një qen mund të trajtohet është shtatë ditë, kur të bëhet operacioni, ndërsa kur bëhet vetëm kastrimi i tyre, lëshohet brenda disa orësh. Ne në të kundërtën, nuk kemi mandate për t'i vlarë, nuk kanë mandat me i mbajtur të ngjuar në një lokacion të caktuar, sepse ata kryejnë shpenzime dhe kështu është, por kështu është lejuar kjo formë e trajtimit të kësaj teme që për çdo ditë kemi presion dhe tash ne nuk mund të garantojmë se për një kohë shumë të shkurtër do të trajtohen të gjithë ata ku janë, dhe ajo çka është dukuria tjetër që efektet ka me i pas shumë të vogla kjo.

Sa i përket pyetjes së znj. Osmani, tha se unë e di që drejtoria është përgjigjur, dhe nëse shërbimi ka harruar për kthimin e saj, kërkoj falje dhe do të interesohem për këtë punë.

Xhelil Bekteshi tha se sa i përket pyetjes së znj. Osmani, për parcelat private ku kalon rrjeti i kanalizimit, ato duhet të shkojnë në Gjykatë, se pastaj po janë pasojat më të mëdha për ne, që të japin deklaratë që po heqin dorë apo që nuk pengojnë, me atë deklaratë vinë tek ne pastaj ne e depozitojmë për me dërguar në Drejtorinë e Kadastrit, se ato tani duhet me kaluar nga private në pronë publike.

Përndryshe, ne po merremi me shpronësim gjithë herë, pas përfundimit të ndërtimit të rrjetit të kanalizimit, kërkojnë me e bërë ndërtimin e rrugës dhe dalin pengesa të tjera.

Behxhet Musliu tha se sa i përket kërkesave të banorëve të lagjes "Kodra e Trimave", ju njoftoj se janë hartuar detyrat projektuese për hartimin e projektit "Kodra e Trimave 1" dhe "Kodra e Trimave 2", ndërsa sa i përket ndryshimit të kufijve të "Zona Ekonomike", ky ndryshim ka hyrë në detyrë projektuese edhe ajo pjesa që ka mbetur jashtë kufirit, d.m.th. me ato ndryshime që janë propozuar.

Për petitionin e paraqitura nga z. Pacolli, konkretisht rreth ndryshimit të koeficientave, tha se ndryshimi dhe plotësimi i secilit plan rregullues i nënshtrohet të njëjtës procedurë sikur kur të nxirret nga fillimi, d.m.th. në këtë vit as nuk kemi plan financiar e nuk mundemi me e paraqit. Eventualisht, mund ta paraqesim në bazë të kërkesës, sepse kemi edhe disa kërkesa tjera, siç është kjo që ka arritur te ne, por mund t'i prezantojmë këtij Kuvendi vetëm kërkesën për fillimin e hartimit për ndryshimin dhe plotësimin e atij ligji, ndërsa realizimi i atij eventual duhet të bëhet në vitin e ardhshëm, ku edhe parashihen mjete buxhetore për këtë punë.

Shemsi Veseli ngriti çështjen e ndarjes së banesave për veteranët e luftës dhe kërkoi nga kryesuesi që ta përdor autoritetin e tij, që të gjithë kolegët mos me ardhur me u sfiduar nesër, sepse është një vendim, i cili bënë një zgjidhje të statusit banesor, sepse ka edhe emra që janë të diskutueshëm, ka që edhe unë i njoh, po ashtu i njeh edhe dikush tjetër.

Është mirë që dosjet, në të dhënat gjenerale të tyre të ceket mosha, të dihet se kush është vërtet veteran. Pra, na mungojnë të dhënat e gjendjes së Kadastrit etj.

Ka kolegë që i është bërë mbindërtimi këtu në qytetin e Prishtinës, që iu është dedikuar banesa dhe tash është mirë me e ditur listën a janë të njëjtit persona që po i merr 1-2 herë, apo faktikisht dikush nuk po merr asnjë herë. Prandaj, kërkoi që të kompletohen dosjet e tërë dokumentacionit të të gjithë përfituesve të banesave.

Lumnjie Rama, kërkesë për Drejtorinë e Arsimit

Meqë koha e pushimeve verore po afrohet dhe institucionet parashkollore shkojnë në pushime kolektive, në afat prej një muaji, e që është një gjë e papërbalueshme për prindër që punojnë, sepse ata detyrohen të paguajnë privat për një muaj, me kërkesën e shumë prindërve, kërkoi që të bëhet një (çerdhe grumbulluese), ku do të shkarkohen fëmijët nga çerdhet tjera, në mënyrë që t'ia lehtësojnë edhe prindërve pushimet vjetore.

Në emër të familjes Hoxha dhe Zejnullahu, kërkoi dhe shprehi shqetësimet e tyre se:

- Cila është kërkesa e tenderit për rregullimin e sheshit "Zahir Pajaziti"?
- Çka është paraparë të punohet, a do të jenë ashtu siç kanë rënë së bashku në altarin e lirisë?
- Si do të realizohet ky projekt?

Mbledhja mbaroi në orën 13:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit
Sami Hamiti, ecc. i dipl.